

LËNDA: Përgjigje ndaj shkresës së QKK-së të datës 07/02/2025

SHQIPTARJA.COM

REPORTTV

ALBANIAN DAILY NEWS

Të nderuar,

U njohëm me kronikën e datës 07/02/2025 dhe reagimin që Kryetari i QKK-së ka bërë në adresë të letrës sonë drejtuar Ministrit, z. Blendi Gonxhja.

Me shqetësim konstatojmë se reagimi i QKK-së nuk përpiqet aspak të adresojë problematikat thelbësore të ngritura në letrën tonë dhe, për më tepër, përdor një gjuhë që thekson ndarjen mes institucionit dhe komunitetit të kineastëve.

Gjithashtu në përgjigjen e Kryetarit me keqardhje konstatojmë tone vetëmbrojtëse, shpërndarje të përgjegjësi dhe akuza ndaj komunitetit. Kinemaja është art kolektiv që kërkon bashkëpunim, dialog dhe respekt të ndërsjellë. Gjuha e përdorur në përgjigje, me terminologjitë si “I ashtuquajturi ankimim”, “sulm të koordinuar e intesiv, përmes manipulimit dhe shpifjeve të bëra botërisht pengimin e ushtrimit të funksioneve dhe reformimit të sistemit”, etj., ndaj një shkrese që evidenton disa shqetësime legjitime të komunitetit, qoftë edhe të një pjese të tij, mendojmë se nuk i shërben zhvillimit të kinematografisë shqiptare, por tregon qëndrim refraktar dhe mbyllje të rrugëve të komunikimit dhe bashkëpunimit.

Në takimin e datës 19 dhjetor 2024 të Kryetarit të QKK me kryetarët e shoqatave janë bërë prezent të gjitha shqetësimet e ngritura në letrën drejtuar Ministrit z. Gonxhja (përveç shkeljeve të konstatuara në mbledhjet e zhvilluara pas takimit). Nga ana e Kryetarit është marrë përsipër që një pjesë e mirë e tyre do të reflektoheshin në ndryshimet e rregullores, ndërkohë që rezultoi e kundërta.

Kineastët shqiptarë në takime personale, apo në grupime, në çdo kohë i kanë garantuar Kryetarit të QKK mbështetjen dhe mirëkuptimin në implementimin e platformës së tij “NGA PROBLEMET TEK ZGJIDHJET” për implementimin e reformave, por fatkeqësisht nuk e kemi gjetur gjuhën e mirëkuptimit dhe për më tepër nuk po konstatojmë asnjë reformë të përmbushur prej gati 1 viti në detyrë.

Me shqetësim të thellë konstatojmë se në përgjigjen e QKK nuk ceket aspak problemi madhor i administrimit të papërgjegjshëm dhe në shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, i buxhetit gjatë vitit 2024. Këshillat e Miratimit të Projekteve janë krijuar pas kërkesës emergjente të Kryetarit të QKK dhe në datën 6 Qershor 2024 është hedhur shorti për krijimin e Këshillave Miratues të Projekteve. Që nga ajo ditë e deri më 15 dhjetor, kur i është kërkuar

takim nga kryetarët e shoqatave të kineastëve, Kryetari i QKK-së ka shkëputur çdo marrëdhënie bashkëpunimi me shoqatat, deri sa arriti në manifestimin e veprimeve të paprecedenta në menaxhimin e fondeve publike ku evidentohen probleme serioze:

### **1) KEQMENAXHIMI I BUXHETIT:**

- Afro 10% e buxhetit total të projekteve është djegur në mënyrë të papërgjegjshme, pavarësisht mbledhjeve të bëra në 10-ditëshin e fundit të muajit dhjetor 2024.

- Shkelja e ligjit dhe shmangia e konkurrencës duke financuar 80% të projekteve që kanë aplikuar. (43 projekte janë kualifikuar në konkurim dhe 34 projekte janë shpallur fitues. Vetëm 9 projekte nuk janë financuar: 4 filma artistikë të metrazhit të gjatë dhe 5 filma artistikë të metrazhit të shkurtër).

- Shpallje fituesish dhe shërndarje të fondeve pa respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara në rregullore lidhur me vlerësimin nga ana e Këshillave Miratues të Projekteve, të cilët kanë marrë vendime në mbledhje urgjente, pa vlerësim të mirëfilltë artistik dhe analizë financiare.

- Disa projekte janë financuar me buxhete të fryra dhe jo në proporcion me financimet e përgjithshme, për më tepër me filmat autor.

- E gjitha sa më sipër ka sjellë që të "KAFSHOHET" buxheti i vitit 2025, duke lënë shumë pak buxhet të lirë për financimin e projekteve për vitin 2025, gjë që do të vërë në vështirësi ecurinë e projekteve në vijim. Kjo situatë do të rëndohet edhe më tej duke marrë informacion nga kalendarit i thirrjeve ku parashikohet që brenda të njëjtit buxhet do të financohen edhe projektet audiovizuale.

- Konstatojmë mungesë transparence për realizimin e buxhetit të vitit 2024 në faqen e internetit të QKK-së, pavarësisht se është detyrim ligjor publikimi i monitorimit të buxhetit çdo 4-mujor.

### **2) DISKRIMINIMI NDAJ KINEASTËVE (PRODUCENTË DHE AUTORË) VENDAS:**

Projektet e metrazhit të gjatë të regjisorëve të karrierës janë përballur me ulje të konsiderueshme të buxheteve, ndërkohë që e kundërta ndodh në rajon e më gjerë. Kjo situatë rëndohet akoma më shumë kur është i pamohueshëm fakti i rritjes së kostove të prodhimit (shërbimeve dhe mallrave, e cila duhet të pasohet edhe me rritje të pagesave njerëzore). Këto financime i vënë produksionet dhe autorët shqiptarë në vështirësi shumë të mëdha për ngritjen e planit financiar dhe realizimin e veprave sipas kalendarit të prodhimit dhe për më tepër me cilësi. Ky fenomen vjen në opozicion me mbifinancimin e projekteve dytësore, veçanërisht ato me autorë të huaj.

Aktualisht janë në proces financimi:

- 11 filma me metrazh të gjatë të kategorisë minority coproduction.
- 2 filma artistikë me metrazh të gjatë (vepër karriere).
- 2 filma artistikë me metrazh të gjatë vepër e parë dhe e dytë (të shpallur fitues në vitin 2021).

Në kalendarin e thirrjeve të vitit 2025 konstatojmë se është planifikuar të hapet sërish konkurs për filmat minority coproduction.

Kinematografia shqiptare po pëson një goditje në zhvillimin e saj të qëndrueshëm. Në vend që të ketë një progres të vazhdueshëm dhe të planifikuar mirë, industria po përballlet me pengesa që e bëjnë të vështirë realizimin e projekteve afatgjata dhe krijimin e një baze të shëndetshme për zhvillim të mëtejshëm.

Ky model menaxhimi demonstroi qartë një qasje të njëanshme dhe diskriminuese ndaj komunitetit të kineastëve vendas. Buxheti i QKK-së nuk është pronë private që mund të administrohet në mënyrë arbitrare - ai është fond publik që duhet të shërbejë për zhvillimin e qëndrueshëm të kinematografisë shqiptare. Djegia e buxhetit, por edhe mbifinancimi për projekte dytësore, ndërkohë që ulen fondet për veprat artistike të metrazhit të gjatë të autorëve shqiptarë, është një praktikë që kërkon vëmendje dhe ndërhyrje të menjëhershme nga strukturat përkatëse mbikëqyrëse.

Pas këtyre konstatimeve i kërkojmë Kryetarit të QKK-së të prononcohet për strategjinë e tij për financimet në periudhën 2025-2028.

### **3) DETYRIMI PËR TRANSPARENÇË BUXHETORE**

Çështja e transparencës buxhetore dhe detyrimeve ligjore të QKK-së paraqet një problem serioz në menaxhimin institucional të fondeve publike. Vendimi i QKK-së për të mos shpallur paraprakisht fondet në dispozicion për thirrjet publike, duke e justifikuar këtë me nevojën për "fleksibilitet", shfaq një interpretim problematik të parimeve të menaxhimit të fondeve publike.

Në thelb të kësaj çështjeje qëndron detyrimi ligjor dhe moral i çdo institucioni publik për të garantuar transparencë të plotë në menaxhimin e fondeve. Ky detyrim nuk është thjesht një formalitet administrativ, por një element themelor i qeverisjes së mirë që siguron përdorim efektiv dhe të përgjegjshëm të burimeve publike. Planifikimi dhe shpallja paraprake e buxhetit për çdo thirrje publike është një praktikë standarde që ndiqet nga të gjitha institucionet buxhetore, duke krijuar kështu një bazë të qëndrueshme për vlerësim dhe monitorim.

Mungesa e transparencës paraprake krijon pasoja të shumëfishta negative.

Së pari, kineastët dhe aplikuesit potencialë pengohen në planifikimin efektiv të projekteve të tyre, pasi nuk kanë informacionin e nevojshëm për të vlerësuar realizueshmërinë financiare të projekteve.

Së dyti, kjo mungesë transparence krijon një klimë pasigurie në komunitetin e kineastëve, duke dëmtuar besimin në institucion. Më shqetësuese është se kjo situatë rrit mundësinë për vendimmarrje arbitrare dhe vështirëson procesin e monitorimit të përdorimit të fondeve publike.

Argumenti i QKK-së për nevojën e "fleksibilitetit" duket më shumë si një justifikim për të shmangur përgjegjshmërinë dhe transparencën, sesa një nevojë reale administrative. Kjo qasje bie në kundërshtim jo vetëm me praktikën e mira të menaxhimit publik, por edhe me standardet e vendosura nga institucionet e tjera buxhetore në vend. Transparenca në menaxhimin e fondeve publike duhet të jetë një proces gjithëpërfshirës që fillon që në fazën e planifikimit dhe vazhdon gjatë gjithë procesit të menaxhimit të projekteve.

#### **4) KUFIZIMET DISKRIMINUESE NDAJ REGJISORËVE DHE PRODUCENTËVE TË RINJ NË RREGULLOREN E MAJIT 2024, TË PËRFORCUARA NË KUFIZIME EDHE ME RREGULLOREN E JANAR 2025**

- Rregullorja e QKK (maj 2024 dhe rregullorja e miratuar në janar 2025) vendos barriera artificiale që pengojnë hyrjen e talenteve të reja në industrinë kinematografike. Kërkesa për diplomë në regji filmi e vendosur si kusht për të gjitha kategoritë, përveç filmave të karrierës, madje edhe për projektet audiovizuale dhe projektet për pasprodhim dhe distribucion, është një kufizim i pashembullt në praktikën evropiane. **E sfidojmë hapur Kryetarin e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë të na tregojë qoftë edhe një institucion homolog në Evropë që ka vendosur kufizime të tilla diskriminuese dhe përjashtuese.**

- Rregullorja nuk parashikon asnjë hapësirë për autorët që janë financuar nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë, por që pavarësisht nga arsyet nuk kanë mundur të ndjekin degë regji filmi, edhe sepse kur ata kanë studiuar nuk ka patur një të degë të tillë. A mund ta mbajë mbi supë barrën e ndërprerjes së karrierës së krijuesve për këta kineastë zoti Kryetar i QKK-së?

- Kritere absurde janë vendosur edhe ndaj producentëve të rinj, të cilat bien në kundërshtim të plotë me praktikën ndërkombëtare dhe për më tepër dhe ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Sipas Rregullores së miratuar nga Kryetari i QKK-së **nuk mund të ndërmarrësh iniciativën private për t'u bërë producent pa patur diplomë në fushat e kinematografisë, audiovizualit, ose shkencave ekonomike e financiare, pa patur të paktën dy kontrata pune në cilësinë e asistentit të produksionit dhe pa paraqitur dy letra rekomandimi nga producentët me përvojë!!!**

- E njëjta situatë me kritere absurde përjashtuese dhe diskriminuese është edhe për Distributorët e rinj, të cilët detyrimisht duhet të kenë diplomë të arsimit të lartë (këtë herë jo të profilizuar në degë të veçanta). Ndërsa vetë sallat e shfaqjes publike (kinematë) që regjistrohen për herë të parë për ushtrimin e aktivitetit të tyre duhet të ngarkojnë në e-albania diplomë të arsimit të lartë.

Në Rregulloren e miratuar në janar 2025 konstatojmë shtrëngime dhe ndryshime të pashpjegueshme lidhur me:

- Afatin e nënshkrimit të kontratave, i cili është reduktuar në 3 muaj për të gjitha kategoritë e projekteve. Për projektet për filma të metrazhit të gjatë, të cilët kanë detyrimin për të aplikuar në Eurimages kjo do të thotë pamundësi për realizimin e projektit. Të pretendosh që një produksion të arrijë të bëjë montazh financiar për projektin brenda 3 muajve dhe ndërkohë të përgatisë edhe aplikimin në Eurimages do të thotë që nuk ke as njohuritë minimale në këtë fushë. Gjithësesi kjo deri diku është e kuptueshme për z. Kryetar të QKK-së, po të marrim parasysh që ka background akademik dhe pa ndonjë përvojë në realizimin e bashkëprodhimeve kinematografike për krijimin e montazhit financiar të një projekti të metrazhit të gjatë.

- Klauzola përjashtuese nga rregulli i diplomës regji filmi vetëm për autorët që janë diplomuar para vitit 1995. Pa asnjë shpjegim është referuar viti 1995, ndërkohë që, duke marrë parasysh kontestimet e rregullores së vitit 2024 nga disa autorë, mund të kishte referuar përjashtimin në vitin që janë diplomuar studentët e parë të degës regji filmi në Akademinë e Arteve, sot Universiteti i Arteve.

- Eliminimi i veprimtarisë së Këshillit Paraprak të Leximit. Në mënyrë të pashpjegueshme është hequr nga Rregullorja e vitit 2025 KPL, ndërkohë që aktiviteti i saj nuk është shfuqizuar nga Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionimit të QKK.

I kërkojmë Kryetarit të QKK që të pronocohet lidhur me qëllimet e ndryshimeve të tilla drastike në rregullore dhe pse nuk ka marrë parasysh asnjë nga kontestimet e kineastëve dhe shoqatave të kineastëve.

## **5) VENDIMI I PALIGJSHËM PËR PROJEKTET NË BASHKËPRODHIM MINORITAR**

Përkundër pretendimit të Kryetarit të QKK-së se nuk ka pasur shkelje të nenit 9 të ligjit "Për kinematografinë", realiteti tregon ndryshe. Janë shkelur të dyja paragrafet e këtij neni, si përsa i përket shkeljes së parimit të përzgjedhjes së projekteve nga Këshillat Miratues të Projekteve, ashtu edhe për procedurën e miratimit të vendimit të KMP nga ana e Kryetarit të QKK-së. Vendimi për të miratuar të 6 projektet në garë dhe rritja artificiale e buxhetit me 20 milionë lekë për projektet e regjisorëve të huaj përbën jo vetëm një precedent të rrezikshëm dhe

shkelje flagrante të parimit të konkurrencës, por edhe një menaxhim të papërgjegjshëm të burimeve financiare të kufizuara të institucionit.

Meqenëse Kryetari i QKK-së këmbëngul që në këtë procedurë nuk ka shkelje dhe se neni 144, mund të zbatohet në këtë rast, sjellim në vëmendjen e tij të lexojë edhe nenin 145 të Kodit të Procedurës Administrative i cili përcakton afatin kohor dhe paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim.

Kryetari i QKK nuk sqaron arsyet e rishikimit të këtij vendimi dhe gjithashtu nuk e bën publik Relacionin për ndryshimin e vendimit të KMP për koproduksionet në pakicë me nr. 436 prot., datë 19 nëntor 2024, që i ka paraqitur KMP-së për rishikimin e vendimit të tij.

**Ky vendim bëhet veçanërisht problematik kur marrim parasysh që buxhetet e akorduara për regjisorët shqiptarë të filmit artistik janë shumë herë më të ulëta se ato të vendeve të rajonit. Duke shpenzuar mbi 30% të buxhetit vjetor të QKK-së vetëm për regjisorë të huaj, institucioni po vë në pikëpyetje vetë misionin e tij për mbështetjen e kinematografisë shqiptare.** Me një buxhet tashmë të kufizuar, kjo rishpërndarje e palogjikshme e fondeve krijon një disbalancë të theksuar në dëm të krijuesve vendas dhe rrezikon seriozisht zhvillimin e qëndrueshëm të kinematografisë shqiptare.

## **6) HEDHJA BALTË MBI PROJEKTET E FINANCUARA NGA QKK**

Me shqetësim konstatojmë në përgjigjen e Kryetarit të QKK një qëndrim tejet problematik ndaj kinematografisë bashkëkohore shqiptare. Krahasimi me periudhën e Kinostudios është thellësisht i pabazuar dhe absurd. Në mënyrë të pajustificuar Kryetari i QKK injoron përpjekjet e kineastëve shqiptarë, të cilët përballen çdo ditë me një treg të mbingarkuar me prodhime kinematografike të mirëfinancuara jo vetëm në prodhi, por të mbështetura financiarisht edhe në lobim për kualifikimin në festivale të rëndësishme, apo edhe në promovim nga shtetet e origjinës.

Kineastët shqiptarë pasi u përballën me traumën e shkatërrimit të infrastrukturës filmike pas viteve '90, mungesën totale të studiove dhe laboratorëve të pasprodhimit të filmit, reduktimin drastik të buxheteve për prodhim filmik, mungesën e mbështetjes shtetërore për shpërndarje dhe promovim duhet aktualisht të përballen edhe me fyerje e nënvlerësim për veprat e tyre duke i quajtur stok.

Kryetari i QKK-së nuk është një kritik arti që i lejon vetes të bëjë vlerësime për filmat, mund të jetë i tillë në profesion, por në funksionin që ushtron ka si mision kryesor të nxitë dhe të reformojë sistemin. E ftojme Kryetarin që me të dhënat që disponon në institucion të publikojë statistika lidhur me financimet e bëra, produktet e financuara dhe arritjet e tyre.

Përkundrazi, ne mendojmë se në totalin e filmave artistikë të metrazhit të gjatë të mbështetur nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë mbi 60% e tyre janë selektuar në festivale ndërkombëtare të kategorisë A.

Producentët shqiptarë kanë arritur me shumë sakrificë të krijojnë bashkëprodhime të suksesshme ndërkombëtare, të sigurojnë qindra vende pune në sektor dhe të ngrajnë ekspertizën profesionale në nivele evropiane. Me mbështetje 30-40% nga buxheti i shtetit, filmat artistikë shqiptarë arrijnë të realizojnë vepra dinjitoze që bëhen pjesë e trashëgimisë kulturore shqiptare. Me një përlogaritje të përafërt bërë nga ana jonë rezultojnë që në 1 milionë euro që shteti shqiptar financohet metrazhet e gjata, si efekt i bashkëprodhimeve bëhen pjesë e filmave 3-4 milionë Euro.

Krahasimi me prodhimet e Kinostudios është krejtësisht i papërshtatshëm duke qenë se Kinostudioja operonte me buxhete të plota shtetërore, ku shumica e filmave shërbenin si vegla propagande, shpërndarja dhe shfaqja ishin të garantuara nga shteti. Në morinë e filmave të prodhuar nga Kinostudioja shumë pak prej tyre prodhime kanë vlera të qëndrueshme artistike.

## **7) SQARIM MBI TAX INCENTIVES DHE POLITIKAT FISKALE, ose vijueshmëria paradoksale e injorancës.**

Me shqetësim konstatojmë një keqkuptim thelbësor në përgjigjen e Kryetarit të QKK lidhur me konceptin e Tax Incentives. Përgjigjimi nga TVSH-ja apo nga tatimi mbi fitimin për shtëpitë prodhuese nuk ka asnjë lidhje me skemën e Tax Incentives që zbatohet në vendet e zhvilluara.

Tax Incentives në industrinë e filmit është një instrument ekonomik krejtësisht i ndryshëm nga lehtësirat e zakonshme fiskale. Kjo skemë përfshin rimbursimin e një përqindjeje të shpenzimeve që produksionet filmike kryejnë në territorin e vendit pritës, pavarësisht statusit të tyre tatimor. Për shembull:

- Kosova 30% tax credit
- Kroacia rimburson 25-30% të shpenzimeve të kualifikuara
- Serbia ofron 25% cash rebate
- Mali i Zi rimburson 25% të shpenzimeve
- Maqedonia e Veriut ofron 20% cash rebate

Këto skema nuk kanë asnjë lidhje me përgjigjet nga TVSH apo tatimi mbi fitimin. Ato janë instrumenta të mirëfilltë ekonomikë që:

- Stimulojnë shpenzimet e produksioneve të huaja në ekonominë vendase

- Gjenerojnë vende pune në sektorin e filmit
- Rrisin ekspertizën teknike të stafit vendor
- Promovojnë vendin si destinacion filmimi
- Krijojnë të ardhura për bizneset lokale (hotele, transport, shërbime, etj.)

Pretendimi se Shqipëria është "**tax free për filmin**" dhe se kjo e bën të panevojshme një skemë Tax Incentives tregon për një mosnjohje të thellë të këtij instrumenti ekonomik dhe të mënyrës se si funksionon industria globale e filmit.

Të këmbëngulësh për të mos implementuar një incentivë të tillë në Shqipëri do të thotë të mos kesh asnjë njohuri për impaktin që kjo sjell në ekonomi, të refuzosh të kuptosh impaktin që kjo incentivë i jep industrisë së filmit, të sabotosh hyrjen e miliona lekëve në ekonominë e vendit. Për periudhën 2024-2025 është mohuar hyrja në Shqipëri e rreth 20 milionë Euro. Kjo shifër është përlogaritur nga kërkesat dhe propozimet që kemi marrë gjatë kësaj periudhe kohe që kjo incentivë keqinterpetohet dhe pengohet me të gjitha mënyrat për t'u implementuar.

## **8) VENDIMARRJA E FILMIT DOKUMENTAR**

Në lidhje me ndarjen e vendimmarrjes së filmit dokumentar i kujtojmë Kryetarit të QKK që nuk mund të bëjë të paditurin për këtë çështje dhe ta shesi fajin tek anëtarët e KMP, të cilët përveç të tjerave përballen me cënimin e aktivitetit dhe punës së tyre, duke marrë në dorë drejtimin e çdo mbledhje që është zhvilluar deri më tani. Mbledhjet janë të regjistruara audio dhe video. Kryetari dhe administrata e QKK-së janë përgjegjës për mirëadministrimin e mbledhjeve, si dhe për udhëzimin e anëtarëve të KMP për rregullat e administratës publike.

## **9) SHKELJA E AFATEVE TË RREGULLORES PËR KOHËN NË DISPOZICION TË KMP PËR TË LEXUAR PROJEKTET KINEMATOGRAFIKE**

I kujtojmë Kryetarit të QKK se Këshillat e Miratimit të Projekteve përbëhen nga përfaqësues të shoqatave të kineastëve dhe ne e kemi informacionin për datën kur janë përcjellë projektet tek anëtarët e KMP. Afati 10 ditor në dispozicion të KMP për të lexuar projektet nuk është respektuar.

## **10) ADRESIMI I PËRGJEGJËSIVE TEK PUNONJËSIT E LARGUAR NGA DETYRA**

Pavarësisht arsyeve që mund të ketë pasur Kryetari i QKK-së, asnjë nga punonjësit nuk është larguar nga puna për shkak të shkeljeve ligjore siç pretendon në përgjigjen drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, por u është komunikuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës në përfundim të periudhës së provës.



Ftojmë Kryetarin e QKK të jetë bashkëpunues dhe të pranojë të paktën që kush punon edhe gabon dhe të marrë përgjegjësi për veprimet e kryera.

Ndërkohë që vijojmë të konstatojmë me shqetësim edhe indiferencën dhe mungesën e reagimit të strukturave të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Kryetaret e shoqatave të kineasteve